REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 shkurt 2019
Nr. ref.:RK 1326/19

# AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI69/17**

Parashtrues

**Xhavit Arifi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 340/2016, të 15 shkurtit 2017**

**GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

## Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Xhavit Arifi nga Rimanishta, komuna e Prishtinës. (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

## Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 340/2016, të 15 shkurtit 2017, të cilin e ka pranuar më 27 mars 2017.

## Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi pretendon se i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

## Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullit 31 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 qershor 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 21 qershor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović.

8. Më 28 qershor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.

9. Më 5 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

10. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

11. Për shkak të periudhës tranzitore dhe ndryshimin në përbërjen e Gjykatës, Aktvendimi për papranueshmëri nuk arriti të marrë formën përfundimtare në përbërjen e vjetër të Gjykatës.

12. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

13. Më 21 janar 2019, Gjykata në përbërje të plotë në seancën administrative vendosi që kërkesa KI69/17 të trajtohet nga faza fillestare dhe që të caktohet një Kolegj i ri shqyrtues.

14. Më 22 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës në përputhje me Vendimin e seancës administrative të gjyqtarëve të 21 janarit 2019 (nr. ref. KK-SP:03-4/19/bo), nxori vendimin GJK. KSH. KI69/17 për zëvendësimin e Kolegjit shqyrtues dhe në kolegj u emëruan gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban, anëtarë.

15. Më 30 janar 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve të rastit

16. Më 15 shkurt 2000, parashtruesi i kërkesës kishte themeluar marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar në Ndërmarrjen Publike Komunale "Trafiku Urban" (në tekstin e mëtejmë: NPK) në Prishtinë, në vendin e punës konduktor autobusi, i cili më vonë e kishte ndërruar në vendin e punës "dispeçer".

17. Më 16 prill 2006, parashtruesi i kërkesës është larguar nga vendi i punës. Gjatë mungesës së tij në vendin e punës, tre persona i kanë marrë dy qoshqe dhe i kanë dërguar në drejtim të panjohur.

18. Më 26 prill 2006, grupi punues për menaxhimin e NPK-së, me Aktvendimin nr. 210, parashtruesin e kërkesës e shpalli përgjegjës për shkelje të detyrave të punës dhe i shqiptoi masën disiplinore "Ndërprerje e marrëdhënies së punës".

19. Më 31 maj 2006, Bordi i NPK-së, si shkallë e dytë, me Vendimin nr. 836, e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi vendimin e shkallës së parë për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi parashtroi padi në Gjykatën Komunale kundër vendimit të Bordit të NKP-së.

21. Më 8 dhjetor 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 158/06, aprovoi si të bazuar padinë e parashtruesit, anuloi si të paligjshme vendimet e NPK-së për ndërprerjen e punës dhe urdhëroi NPK-në që parashtruesin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

22. Kundër këtij aktgjykimi në *"afatin ligjor"* e paditura NPK, ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

23. Më 14 tetor 2008, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktvendimin Ac. nr. 528/2007, prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 158/06 dhe çështjen e ktheu në rigjykim në shkallë të parë.

24. Më 30 korrik 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 373/08, duke rivendosur lidhur me çështjen, e miratoi padinë e parashtruesit si të bazuar, anuloi vendimet e NPK-së me të cilat parashtruesit i ndërpritej marrëdhënia e punës dhe urdhëroi kthimin e tij në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

25. Më 20 gusht 2013, NPK kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

26. Më 19 shtator 2016, me Aktgjykimin CA. nr. 2735/2014, Gjykata e Apelit e Kosovës, refuzoi si të pabazuar ankesën e paraqitur dhe vërtetoi në tërësi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

27. Më 26 tetor 2016, NPK paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

28. Më 15 shkurt 2017, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 340/2016 vendosi të: *"Miratohet si i bazuar revizioni i të paditurës NPK "Trafiku urban" në Prishtinë, ndryshohen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2735/2014 datë 19.9.2016 dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 373/2008 datë 30.7.2013, ashtu që refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Xhavit Arifi nga Prishtina"*.

29. Më 5 prill 2017, parashtruesi iu drejtua Prokurorisë së Shtetit me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

30. Më 24 prill 2017, Prokuroria e Shtetit me njoftimin KMCL. nr. 37/2017, kishte njoftuar parashtruesin se kërkesa e tij ishte e palejuar, dhe gjithashtu e pa-afatshme.

**Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

31. Parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtën e punës ngase aktgjykimi për revizion i ka ndryshuar vendimet gjyqësore të gjykatave të shkallëve më të ulëta të cilat kanë qenë në favor të tij, sepse *"kanë konstatuar gjendjen faktike ndryshe nga gjendja reale"*.

32. Parashtruesi më tej ka potencuar se pafajësia e tij lidhur me shkeljen disiplinore që i vihet në barrë vërtetohet edhe me Aktgjykimin C. nr. 373/08, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilin ishte liruar nga ndjekja penale pas heqjes dorë nga propozim-akuza nga ana e prokurorit të rastit. Rasti penal, sipas parashtruesit lidhej me procedurën disiplinore që është zhvilluar kundër tij.

33. Parashtruesi ka kërkuar nga Gjykata anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën për revizion duke potencuar se më këtë vendim gjyqësor atij i është shkelur e drejta në punë dhe i është mohuar ushtrimi i profesionit, e drejtë kjo e mbrojtur me nenin 49 të Kushtetutës. Parashtruesi kërkon kthimin e tij në vendin e punës apo një vend tjetër që i përgjigjet kualifikimeve dhe aftësive të tij për punë.

**Pranueshmëria e kërkesës**

34. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafi 7 i Kushtetutës, i cili parasheh:

> *"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

36. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

37. Së fundi, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

38. Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit i përmbush kriteret e nenit 113.7 sa i përket palës së autorizuar dhe shterjes së mjeteve juridike që është parashtruar brenda afateve të nenit 49 të Ligjit, andaj gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse janë përmbushur kushtet e rregullit 39 të Rregullores së punës.

39. Gjykata vëren se parashtruesi ka pretenduar në mënyrë specifike se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 340/16, atij i është shkelur e Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit (Neni 49 i Kushtetutës), i cili ka përmbajtjen si në vijim:

> **Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]**
>
> 1. *E drejta e punës garantohet.*
> 2. *Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.*

40. Gjykata vëren se argumentet e parashtruesit lidhur me shkeljen e së drejtës së punës konsistojnë në konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga ana e Gjykatës Supreme. Ndryshe nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, të cilat sipas parashtruesit kishin konstatuar me të drejtë pafajësinë e tij, lidhur me një rast të vjedhjes së pronës (dy qoshqe) së NPK-së, për të cilën parashtruesi mbahej përgjegjës dhe për të cilën si pasojë iu ndërpre marrëdhënia e punës.

41. Gjykata konstaton se Gjykata Themelore në Prishtinë duke vendosur lidhur me padinë e parashtruesit, kur e kishte miratuar atë si të bazuar, kishte konstatuar, ndër të tjera, se "*Gjykata në rastin konkret ka gjetur se në asnjë mënyrë paditësi nuk ka qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e lokaleve të kompanisë pasi, nga përshkrimet e punës qoftë të konduktorit të autobusit apo të dispeçerit nuk parashihet detyrimi i punëtorit, i punësuar në ndonjërën nga këto pozita, të bëjë punën e rojtarit të ndërmarrjes. Detyrat dhe përgjegjësitë e paditësit janë përshkruar qartazi në rregulloren e të paditurës për sistematizimin e vendeve të punës. Prandaj, sanksionin më të rëndë të shqiptuar për paditësin gjykata e gjeti si të palejuar dhe i paligjshëm*".

42. Gjykata, më tej, vëren se Gjykata e Apelit në arsyetimin e Aktgjykimit CA. nr. 2735/2014 ka theksuar "*Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt dhe plotësisht ka konstatuar gjendjen faktike, dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit ankimor, sepse në bazë të gjendjes së çështjes si dhe akteve normative të paditurës, nuk rezulton se paditësi për shkak të largimit nga vendi i punës të ketë bërë shkelje të rënda të detyrave të punës, si pasojë e të cilave do të mund të shqiptohej masa disiplinore ndërprerje e marrëdhënies së punës. Paditësi nuk e kishte cilësinë e rojtarit të pasurisë së të paditurës, ndërsa në procedurë penale nuk është provuar se ai ishte i përfshirë në rastin kriminal-të vjedhjes së kioskave përkatëse*".

43. Në vijim si më sipër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e revizionit, ndër të tjera, kishte theksuar "*Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët drejt dhe në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike por në bazë të gjendjes së tillë, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale ...*".

44. Gjykata Supreme më tej ka arsyetuar "*Kjo ngase nga provat që gjenden në shkresat e lëndës në mënyrë të sigurt dhe bindëse rezulton përgjegjësia e paditësit për shkelje të rëndë të detyrave të punës. Paditësi, duke mos respektuar urdhrin e drejtorit të kompanisë për ta ruajtur pasurinë e Kompanisë i njëjti më datë 16.4.2006 në ora 15:30 ka lëshuar vendin e punës, dhe nuk është kthyer gjer në ora 18:30 dhe gjatë kësaj kohe në mungesë të paditësit në punë, nga lokacioni i Kompanisë tre persona me një kamion kanë marrë dy kioska*".

45. Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit dhe provave të paraqitura në kërkesë, Gjykata thekson se parimisht nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme në rastin konkret, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

46. Për më tepër, Gjykata vëren se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndalon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin, dhe se një masë e tillë ndaluese nuk i ishte shqiptuar me asnjërin nga vendimet e gjykatave të rregullta. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit që do të arsyetonte përfundimin se është shkelur e

drejta e tij kushtetuese në punë dhe ushtrim të profesionit. (Shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14).

47. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu vlerëson se parashtruesi pretendonte se Gjykata Supreme nuk e kishte vlerësuar drejt dhe të plotë gjendjen faktike e që është qartazi çështje e ligjshmërisë, ndërsa në anën tjetër nuk kishte paraqitur asnjë dëshmi se si dhe në çfarë mënyre iu kishte cenuar e drejta e punës apo i ishte mohuar ushtrimi i profesionit.

48. Pretendimit se ishte liruar nga përgjegjësia penale për rastin që për pasojë ka pasur edhe procedurën disiplinore të udhëhequr ndaj tij, Gjykata Supreme i është përgjigjur qartë, duke theksuar *"Fakti se paditësi është liruar nga përgjegjësia nuk paraqet bazë ligjore për miratimin e kërkesëpadisë së paditësit pasi që procedura disiplinore dhe ajo penale janë dy procedura që zhvillohen në mënyrë të pavarur. Prandaj, janë të bazuara parashtrimet në revizion që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale për çka kjo Gjykatë vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit".*

49. Gjykata më tej thekson gjithashtu se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

50. Si përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa në baza kushtetuese nuk është e arsyetuar dhe se parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e ka dëshmuar e as mbështetur me prova pretendimin për shkelje të një të drejte kushtetuese; andaj, në përputhje me rregullin 39 (2) kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 31 janar 2019, njëzëri

## VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese** **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Arta Rama-Hajrizi